



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 013/25 Dt. 13.01.2025

Republika e Kosovës

Republika Kosova / Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit / Opština Prizren / Prizren Belediyesi

Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale / Direktoriat za Rad i Socijalno Staranje / İş ve Sosyal Esirgeme Müdürlüğü



RAPORTI I PUNËS JANAR-DHJETOR 2024

Drejtorja e Punës dhe Mirëqenies Sociale



Rasim Demiri

Drejtor I DPMS

DPMS

Hyrja

Raporti i punës së Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale gjatë muajve Janar -Dhjetor 2024 ku përfshinë çështje që ndërlidhen me mirëqenien sociale në Komunën e Prizrenit. Në këtë raport paraqiten të përmbledhura aktivitetet që janë realizuar nga Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Prizrenit e udhëhequr nga Rasim Demiri, duke ndërlidhur monitorimin dhe koordinimin me Qendrën për Punë Sociale, Qendrën rezidenciale dhe Shtëpinë për të moshuar. Në periudhën raportuese, Drejtoria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në përmbushje të mandatit të saj është ballafaquar edhe me sfida të shumta, siç janë: ndryshimet e shumta në kornizën ligjore, procesi i plotësimit të pozitave të lira si në Drejtorinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale ashtu edhe në Qendrën për Punë Sociale, numri i lëndëve dhe kërkesave të trashëguara nga vitet paraprake dhe buxheti i pamjaftueshëm për realizimin e të gjitha projekteve sociale.




Figure 1: Organogrami i DPMS-së

Në tabelën janë të paraqitur numri i personelit të cilët janë të angazhuar aktualisht, ku në kabinetin e drejtorisë janë të angazhuar vetëm 2 persona.

	DPMS	QPS	SHPAK	SHM	
Nr. i punëtorëve	3	20	13	10	-

DPMS

Projektet

Projekti Ndërtimi i banesave sociale ne Lagjen Petrovë Kulla 4 (Vazhdim i projektit).

Kemi filluar fazën e vazhdimit të punimeve për përfundimin e këtij objekti, punët e të cilit janë ndërprerë vite me parë. Vlera e paraparë e këtij projekti është 492 ,000.00 Euro. Te realizuara 50.000,00 Euro. Jani vendosur dritaret e reja pasi te vjetrat ka qen te demoluar puna po vazhdoni sipas planit dinamik.

Renovim i banesave kolektive në Lagjen Petrovë Kulla 3 (Vazhdim i projektit).

Kemi filluar fazën e vazhdimit të punimeve për përfundimin e këtij objekti kryesisht punë të brendshme pasi objekti është demoluar, punët e të cilit janë ndërprerë vite me parë dhe nuk ka arritur të finalizohet. Vlera e e investimit është 289,916.20. Janë realizuar 254,030.00Euro. ka përfunduar pjesa ma e madhe e punës pasi ky projekt është dy vjeçar.

Ndërtimi i shtëpisë për të moshuar (vazhdim i projektit) -Projekti për rregullimin e infrastrukturës se jashtë ka përfunduar Vlera e kontratës: 94.250,00. Janë realizuar 84,521.00 Euro. Aneks për përfundimin e punimeve të pa parashikuara vlera: 9.220.00 Euro të realizuara 8.220,00. Stafi është rekrutuar

Furnizim me inventar për shtëpinë të moshuarve.

Është në fazën e furnizimit me inventar të brendshme, është ideuar projekti dhe është në fazën e procedurave të tenderim vlera e parashikuar 153.900.00 Euro.

Ndërtimi i Qendrës për Punë Sociale 2 (QPS 2) – Ky projekt është dy vjeçar, puna për ndërtimin e tij ka filluar në vitin 2023 dhe vlera e përgjithshme e kontratës: 204.060,00 Euro. Janë përfunduar punimet e ndërtimit të Vrazhdë fasada dhe suvatimi, Ka filluar faza e punimeve të brendshme dhe deri tani është realizuar : 149,645.00 Euro. Puna është duke u zhvilluar sipas planit dinamik të kontratës. Anekskontrata për ndërtimin e QPS2 vlera: 20.354,15 e realizuar.

Ndërtimi i shtëpive për familjet në vështirësi ekonomike dhe rastet Sociale me qelsa ne dore – Është ne fazën e projektimit , është ndarë parcela e cila gjendet në Lagjen e Trimave.

Ndërtimi kulmeve për familjet skamnore - është projekt i miratuar dhe jemi në fazën e vlerësimit mbi impaktin financiar, kanë aplikuar 92 familje .

Ndërtimi i shtëpisë emergjente për mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë projekt është ndarë parcela ku do të ndërtohet objekti është. Është në procedura të tenderimit Vlera e paraparë për këtë investim 660.000,00Euro.

Ndërtimi i qendrës rekreative sportive: Po vazhdojnë punimet jemi ne fazën e ndërtimit te vrazhdë. Vlera e investimit është 168,242,72 Euro. Të realizuara 45.803,20.

Blerjeje e veturës për shtëpinë e të moshuarve. Kemi blerë veturë për të shtëpinë te moshuarve vlera e kontratës 29,000.00Euro e realizuar.

Blerjeje e automjetit për shtëpinë rezidenciale.

Vlera e kontratës 36,840.00 jan realizuar 20,000.00Euro

Projektet tjera

Furnizim me lëndë djegëse (dru) për familje të dëshmorëve, invalidëvetë luftës së UÇK-së dhe rastet në vështërsi ekonomike. Po vazhdon shpërndarja për 824 familje nga 3 m3 dru.

Vlera e kontratës 164,882.40 Euro

DPMS

Furnizimi me pakove ushqimore dhe hixhenike për rastet sociale dhe grupet në vështirosi sociale. Do të shpërndahen 1200 pako ushqimore për këto kategori. Vlera e kontratës është 59,700.00 Euro.

Furnizimi me medikamente për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara – është kontratë e cila rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave për medikamente për banorët e shtëpisë me probleme të shëndetit mendorë. Projekt dy vjeçar i cili vijon. Vlera e kontratës 3.985.25 Euro, të realizuara 1.094,50 Euro

Furnizimi me ushqim dhe pije për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me aftësi të kufizuara – rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave nga rezidentët e shtëpisë me bazë në komunitet për persona me probleme të shëndetit mendor: . Vlera e kontratës: 33.3229,40Euro.

Furnizim me veshmbathje për shtëpinë me bazë në komunitet për persona me probleme të shëndetit mendor dhe Shtëpisë së të moshuarve.

Jemi në fazën e vlerësimit të ofertave. Vlera financiar e paraparë është: 40.000,00 vlerë.

Blerje e frigoriferëve, televizor, dhe pajisjeve të tjera për shtëpinë rezidenciale – Projekt i realizuar vlera e kontratës: 3.844,00 Euro. E realizuar

Hartim I projekteve të ndryshme për DPMS – Është lidh kontrata me operatorin ekonomik dhe vlera e kontratës është 50.000,00 Euro, projekt 2 Vjeçar. Të realizuara 39,569.00

Shërbime transporti për bartjen e fëmijëve dhe familjarëve të tyre me vështirësi sociale – Është lidh kontrata me operatorin ekonomik dhe vlera e kontratës është 13.350,00 Euro, projekt i cili vlen 250 ditë. Të realizuara 4,752.00

Mbikëqyrje e punimeve të projekteve të DPMS-së – është kontratë e cila rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave për mbikëqyrjen e projekteve të DPMS. Projekt dy vjeçar i cili vijon. Vlera e kontratës 7.000.00 Euro, të realizuara 2.102,60 Euro.

Furnizim me produkte hixhenike për shtëpinë rezidenciale – është kontratë e cila rrjedh si kërkesë e plotësimit të nevojave për banorët e shtëpisë rezidenciale. Projekt dy vjeçar i cili vijon. Vlera e kontratës 4.58,7.50 Euro, të realizuara 2.728,30 Euro.

Mbulimi i shpenzimeve të varrimit për të gjithë qytetarët e komunës së Prizrenit – ku është arritur marrëveshja me Ndërmarrjen Publike “Ekoregjioni” dhe bashkësitë fetare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit dhe mirëmbajtjen e hapësirave. Edhe më tutje vazhdojnë pagesat sipas faturave mujore bazuar në rastet e vdekjeve në komunën e Prizrenit. Projekti planifikohet të arrij vlerën prej 310,000.00 Euro. Të realizuara **200.000,00 Euro.**

Subvencionet

Subvencionimi i realizimit të projekteve të OJQ-ve dhe individëve në fushën e shërbimeve sociale: DPMS ka mbështetur 29 OJQ në vlerën totale prej 85,000.00 Euro

Subvencionimi i familjeve strehuese - Këtu kemi paraparë pagesën e familjeve strehuese që strehojnë fëmijë të braktisur të komunës tonë. Vlera e paraparë për këtë kategori është 25.000.00 euro.

Subvencionimi i familjeve në vështirësi ekonomike me pagesë të qirasë – Pas aplikimit komisioni ka përzgjedh 26 familje të cilat do të përfitojnë nga pagesa e qeras. 18 familje kanë plotësuar kushtet dhe i është paguar qiraja për 1 vit në vlerën prej 23.862,00.

Me vendim të kryetari paguajm qira për 11 familje të marginalizuara.

Strategjitë komunale

Strategjia komunale për persona me aftësi të kufizuar në Komunën e Prizrenit - Ka kaluar dhe është miratuar në Kuvendin Komunal dhe është në fazën e implementimit.

Plani i punës për ekipin për të Drejtat e Fëmijës në Komunën e Prizrenit 2024-2026 – Ky dokument i ka kaluar të gjitha fazat duke u votuar unanimisht në Kuvendin Komunal Prizren. Jemi në pritje të ligjshmërisë nga MAPL.

Plani lokal i veprimit kundër dhunës në familje. Ka kaluar fazën e dëgjimit publik është në fazën e analizimit të komenteve.

Statuti i qendrës për punë sociale. Është krijuar ekipi profesionalë është në fazën e draftimit fillestar.

Memorandume bashkëpunimi

Terres des Hommes – Po vazhdon projekti ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe OJQ- TDHK në qendrën ditore Nashec, projekt i cili ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve duke ju ofruar qëndrim ditor kualitativ dhe ambient sipas standardeve më të larta.

Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Prizrenit dhe OJQ CONCORDIA -Ky projekt ka për qëllim bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve për t'u mundësuar fëmijëve, të rinjve, grave, familjeve dhe komuniteteve të cenuara në Komunën e Prizrenit që të bëjnë një jetë të vetëvendosur pa marginalizimin dhe diskriminimin, duke fuqizuar sistemin lokal të mirëqenies. Ky projekt është subvencionuar me: 16.140,00 EURO

OPDMK – Në bashkëpunim me OPDMK kemi hap qendrën ditore fizio-terapeutike për persona me distrofi muskulore në sheshin e lidhjes.

Bashkëpunimet me OJQ-të dhe individ të tjerë në mbështetje të komunitetit

OJQ Bereqeti - Janë shpërndarë 220 pako ushqimore, 100 thes miell për familje të përzgjedhura në vështirësi sociale.

Islamic Relief Kosova - Janë shpërndarë 152 pako ushqimore për familje të përzgjedhura në vështirësi sociale.

Shoqata Jetimët e Ballkanit - Janë shpërndarë 230 pako ushqimore për familje të përzgjedhura në vështirësi sociale.

Donator Anonim - Janë shpërndarë 4.000 kg miell për familje të përzgjedhura në vështirësi sociale.

“Esnaf” Veshmbathje për 500 persona

Lënd djegëse (Dru) -Parku nacional “Sharr” – Janë mbështetur 30 Familje, raste në vështirësi ekonomike.

DPMS

Titulli i kontratës (Emërtimi i plotë)	Vlera gjithsej e kontratës	Vlera e shpenzuar deri 31.12.2024	Vlera e mbetur e kontratës
Blerja e veturës për shtëpinë e pleqëve	29,000.00	29,000.00	0.00
Ndërtimi I banesave sociale në Lagjën Petrovë -Prizren	492,000.00	50,000.00	442,000.00
Nërtimi I shtëpisë së pleqëve	94,250.00	84,521.00	9,729.00
Ndërtimi I QPS -2	204,060.00	149,645.00	54,415.00
Blerja e automjetit për shtëpinë rezidenciale	36,840.00	20,000.00	16,840.00
Ndërtimi I aneksit te shtëpia rezidenciale (salla për rekreacione fizike -sportive	168,242.79	45,803.20	122,439.00
Financimi I shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve	0.00	0.00	0.00
Renovimi I banesave kolektive sociale në Lagjën Petrovë (kulla 3 Petrovë) projekt dy vjeçar	289,916.20	254,030.00	35,886.00
Furnizim me mjete hixhienike për shtëpinë rezidenciale	4,587.50	3,037.45	1,550.00
Furnizim me barna dhe material shpenzues sanitar per shtepin rezidenciale	3,985.25	1,682.15	2,303.00
Furnizim me veshmbathje për shtëpinë rezidenciale ne Prizren	9,815.00	6,500.00	3,315.00
Furnizim me ushqim për shtëpinë rezidenciale ne Prizren	38,560.95	24,452.09	14,108.00
Aneksë kontratë për ndërtimin e shtëpisë së pleqëve	9,220.00	8,220.00	1,000.00
Aneksë kontratë për ndërtimin e QPS 2	20,354.15	20,354.15	0.00
Shërbime transporti pë bartjen e fëmijëve dhe familjareve te tyre me veshtersi sociale	13,350.00	4,752.00	8,598.00
Hartimi I projek.te ndryshme ideore dhe kryesore për ndërtim dhe renovim te objek,sipas DPMS	50,000.00	39,569.00	10,431.00
Blerja e frigorifereve ,televizor dhe paisje tjera për shtëpinë rezidenciale	3,488.00	3,488.00	0.00

Banimi Social

Objekteve komunale të cilat shfrytëzohen si objekte për banim të veçantë në kuadër të drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale-Prizren

DPMS

Nr	Emertimi	Statusi	Kate	Njesi Banesore	Familje	Anëtarë
1	Dardani Blloku 1	E banueshme	3	12	12	
2	Dardani Blloku 2	E banueshme	3	12	12	
3	Dardani Blloku 3	E banueshme	5	12	12	
4	Petrovë Blloku 1	E banueshme	5	30	30	
5	Petrovë Blloku 2	E banueshme	5	30	30	
6	Petrovë Blloku 3	E ndertuar	5	30		
7	Petrovë Blloku 4	E filluar	5	30		
	Lagjia "sami koka"	E banueshme	1	26	26	
				162	162	

Shtëpia me bazë në komunitet (Rezidenciale) Shtëpia me bazë në komunitet për personat me retardime mendore, janë të vendosur 13 persona. Gjatë muajit maj komision ka vendosur që të strehohen dhe një person tjetër. Kapaciteti i qendrës është 14 persona.

Qendra për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale është institucion i cila vepron në kuadër të komunës së Prizrenit. QPS ka për detyrë të ofroi shërbime profesionale të mbrojtjes sociale dhe të ushtroi autoritetin e tyre i cili buron nga ligjet mbi mbrojtjen sociale dhe nga ligjet tjera relevante si dhe ato ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të dedikuara për mbrojtjen e viktimave të dhunës, trafikimit, çrregullimeve familjare, besimi i fëmijëve, kujdestaria (pra kujdesi ndaj fëmijëve), të rriturve dhe të moshuarve. Në kuadër të Qendrës për Punë Sociale funksionojnë dy shërbime: Shërbimit social familiar Schema e assistances sociale.

Shërbimet Sociale Familjare-Raporti i shërbimeve sociale familjare për periudhën Janar – Qershor 2024 është si në vijim:

Kategoritë	Gjinia		Totali	Vërejtje-Sqarime
	F	M		
Fëmijët e braktisur	2	2	2	Janë marre veprimet e nevojshme
Vërtetimi i atësisë				
Fëmijët me Nevoja të Veçanta	12	21	33	Përgatitja e lendeve për komision mjekësore te cilët i nënshtrohen komisionit te nivelit qendror

DPMS

Regjistrimi i mëvonshëm i fëmijëve	1		1	Janë marre veprimet nevojshme
Viktima qe përjetojnë dhune , abuzuar te keqtrajtuar	133	26	159	Njoftim nga policia e mitur e keqtrajtuar rasti është duke u trajtuar. .
Te mitur nga Prokuroria Themelore	1	90	91	Njoftim nga prokuroria për rastet ne fjale për vepra tjera te jashtë ligjshme ,Rastet ne trajtim.
Te mitur, Gj Themelore .Kundërvajtje	4	47	51	Njoftim nga gjykata për kundërvajtje për rastet ne fjale pasi dyshoh për shkelje ligjore. Për rastet janë përgatitur raporte për gjykatë.
Heqja e drejtës prindërore				
Te mitur Policia	9	9	18	Duhet te behet vlerësimi i përshtatshmërisë për adoptim. Rasti ne procedurë
I mitur Aktvendim GJ.Th	1	8		Janë ndërmarre procedurat e nevojshme
Urdhërmbrojtje	3	2	5	Është ofruar shërbimet e nevojshme sociale
Tentim vetëvrasje	4		4	Rast nga muaji i kaluar i cili ka përdor mjete kimikale ,domestos ,lexi referuar ne QSHM.
Fëmije me sjellje asociale	1	1	2	Këshilla prindërve për kujdes me te shtuar prindëror
Te riatdhesuar				
Shkurorëzimet	21	9	30	Vlerësim për gjykatë ,intervista ,vizita ne teren ,realizim i kontakte
Besimi i fëmijëve- Jashtëmartesor	23	8	31	Vlerësimi dhe mbrojtja e interesave te fëmijëve
Kontakti fëmijëve me prindin tjetër			78	Përcjellja e rasteve ne vazhdimësi sipas vendimit te gjykatës dhe sugjerime e nevojshme
Bashkimi familjar i fëmijëve. moshuar	14	2	16	Është përpiluar raport social për bashkim familjar
Mosmarrëveshjet familja.	3		3	Këshilla, sugjerime
Pëlqim për trashëgimi	12	8	20	Është dhënë vërtetim për te mbrojtur interesat e fëmijëve
Kujdestari për rastet e veçanta	6	3	9	Raport gjykatës dhe caktimi i kujdestarit te përkohshëm.
Vërtetim për nënshtetësi	51	68	119	Vërtetim për lirim nga nënshtetësia e Kosovës
Vërtetim për punë	20	55	75	Vërtetim për punësim –nuk është marre aftësia për veprim
Vërtetim për armë	2	811	813	Vërtetimet lëshohen ne baze te raportit te komisionit mjekësor.
Anamnezë-vertet.gjendj.sociale te tjera	11	11	22	Verifikim i gjendjes faktike

DPMS

Dorëzimi i shkresave ne Gj.Th-D.k-proku. etj			56	Përcjellja e shkresave me poste ose fizike
Dorëzimi i shkresave me post (thirrjet)			124	Përcjellja e shkresave me poste ose fizike
Caktimi i përfaqësuesit te perkohshëm	2	1	3	Janë marre veprimet e nevojshme për shtim te kujdesit nga ana e prindërve
Te mitur Policia	4	21	25	Është kontaktuar me palët
Kerkese per pashaporta te fëmijëve	54	27	81	Janë njoftuar palët se mbi realizim e kontaktimit
Ndryshim i besimit te femiu	1		1	Është proceduar kërkesa për shqyrtim
Dëbim nga shtëpia	1		1	Mbështetje sociale për rastin dhe familjen
Braktisje e fëmijës	1		1	
Krekës nga QSFG				
Ndryshim i vendimit lidhur me kontaktin nga GJ.Th	1	2	3	Janë ofruar shërbimet e nevojshme sociale
Heqja e zotësisë së veprimit	7	7	14	Janë marre veprimet e nevojshme
Kërkesë për familjen biologjike	1	1	2	Janë marre veprimet e nevojshme
Person pa përkujdesje				Janë ofruar shërbimet e nevojshme sociale
Kërkesë për strehim familjar te fëmijës	2	1		Sugjerime për mundësinë e strehimit
Martese para moshës madhore	2		2	Janë marre veprimet e nevojshme sociale

SKEMA ASISTENCËS SOCIALE

Skema e asistencës sociale pranë QPS-së në Prizren gjatë periudhës kohore Janar - Nëntor të vitit 2024 ka punuar në identifikimin e rasteve sociale, vlerësimin dhe monitorimin e tyre, gjithnjë duke u bazuar në ligjin e asistencës sociale 2003/15 dhe plotësim ndryshimin e Ligjit 04L-096 për Skemën e ndihmës sociale i zbatueshëm në Republikën e Kosovës, gjithashtu gjatë kësaj periudhe ka filluar edhe procedura e pilot projektit te skemës sociale ku deri me tani kemi verifikuar dhe vlerësuar mbi 600 raste te reja. Gjatë muajve shtator, tetor dhe nëntor, nga ministria e financave, kemi qene te angazhuar edhe me shtesat e fëmijëve në ri aplikimin e tyre.

DPMS

Numri i shfrytëzuesve të ndihmës sociale në kohën kur ne po raportojmë është 626 familje me 2122 anëtarë.

Muaji	Numri i familjeve	Numri i anëtarëve	Shuma e mjeteve në total €
Janar	665	2315	77.490,00
Shkurt	672	2344	78.550,00
Mars	673	2230	78.190.00
Prill	670	2297	77.520.00
Maj	673	2311	78.000.00
Qershor	665	2270	76.490.00
Korrik	659	2259	76.080.00
Gusht	650	2232	75.050.00
Shtator	646	2209	74.460.00
Tetor	635	2159	73.270.00
Nentor	626	2122	72.030.00
Dhjetor	/	/	/
-Gjithsejtë	Varion nga 665 në muajin janar 2024,në deri më 626 familje në muajin Nentor 2024	Varion nga 2315 deri 2122 anëtarë	837.130.00

AKTIVITETET	KATEGORIA I	KATEGORIA II	TOTALI
Numri i familjeve të verifikuara –	523	213	736

Gjatë kësaj periudhe kur po raportojmë shërbimi i SAS-it ka përgatitur 371 lënd për komisionin mjekësor i cili çdo muaj mban seanca në Qendrën për punë Sociale dhe Shqyrton rastet sipas raporteve mjekësore të paraqitura nga shfrytëzuesit e ndihmës Sociale.Sipas evidencës së Shërbimit Protokollar të SAS-it deri më tani ka lëshuar 184 vërtetime sipas kërkesës së palëve.